



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 75

Tiranë – E enjte, 14 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Punëve të Jashtme nr. 91, datë 14.4.2015	3349
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 17.4.2015	3349
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 17.4.2015	3350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 17.4.2015	3351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 17.4.2015	3351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 17.4.2015	3352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 17.4.2015	3352
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 17.4.2015	3355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 54, datë 23.4.2015	3356

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 55, datë 23.4.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Nishova”, me fuqi totale 1.36 MW.....	3357
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 56, datë 23.4.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3358
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 57, datë 23.4.2015	Për licencimin e shoqërisë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3359
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 58, datë 23.4.2015	Për licencimin e shoqërisë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.....	3359
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 59, datë 23.4.2015	Për licencimin e shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3360
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 60, datë 23.4.2015	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shtika”.....	3360
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 61, datë 23.4.2015	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	3361
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2577, datë 29.4.2015	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë, loti II (objektet)”.....	3362
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasës Rozalia Bashi.....	3363
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Nevruz Brahilika.....	3363
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Aqif Rusi.....	3363
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Agim Ragip Uligaj.....	3363
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Agron Mehmeti.....	3363
	Ndreqje gabimi.....	3364

**URDHËR****Nr. 91, datë 14.4.2015****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 27 e vijues, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Delegimin e kompetencës së ministrit të Punëve të Jashtme, si vijon:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Punëve të Jashtme në proceset gjyqësore, prokurori, zyrat e përmbartimit gjyqësor, të lëshohen nga drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Çështjeve Juridike, në emër të personit që do të përfaqësojë Ministrinë.

2. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Punëve të Jashtme në marrëdhënie me institucionet e parashikuara, sipas pikës 1 të këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të caktuar të kryejë çdo veprim procedural, të parashikuar nga ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kuadër të përfaqësimit në shkallën përkatëse të gjykimit. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Çështjeve Juridike autorizon përfaqësuesit për pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme në seancat gjyqësore, në emër dhe për llogari të institucionit.

3. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Çështjeve Juridike nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe me pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

VENDIM**Nr. 47, datë 17.4.2015**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“MESOPOTAM ENERGJI” SHPK, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“DRIZA”, ME FUQI TOTALE 3,408 MW**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 10/3; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Mesopotam Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Koxheraj”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.1. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.2. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3. Është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni teknik-ekonomik është plotësuar pjesërisht. (Nuk është paraqitur vlerësimi i MEI-t për oponencën teknike të AKBN-së.)

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera. Është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për



procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Driza”, me fuqi totale 3,408 MW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 48, datë 17.4.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MESOPOTAM ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 3, pika 35/n, 8, germa “a”, neni 9 dhe neni 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “g”; neni 8 dhe neni 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Mesopotam Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar. E paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”. Plotësuar.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera.

Është plotësuar tërësisht.

Është në proces miratimi i pikës së lidhjes me sistemin.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Mesopotam Energji” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 49, datë 17.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ROBERTO OIL” SHA NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; nenit 5, pika 2; 8 dhe 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Roberto Oil” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Roberto Oil” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 gerrat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Roberto Oil” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 50, datë 17.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ROBERTO OIL” SHA NË
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4; dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 13 dhe 14, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Roberto Oil” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Roberto Oil” sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.



- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9, germa “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Roberto Oil” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 51, datë 17.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KOXHERI ENERGJI” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“KOXHERRAJ”, ME FUQI TË
INSTALUAR 0,62 MW,
ME AFAT 30-VJEÇAR**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Koxheri Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Koxherra”, me fuqi të instaluar 0,62 MW, për një afat 30-vjeçar,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koxheri Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Dokumentacioni i përgjithshëm i përcaktuar në nenin 9, pika 1 (formati i aplikimit); nenin 9, pika 2 (dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor); nenin 9, pika 3 (dokumentacioni financiar dhe fiskal) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik lidhur me tipin e licencës, të përcaktuar në nenin 9, pika 4.1.1 (të dhëna specifike për HEC); neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin); neni 9, pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik); neni 9, pika 4.1.4 (dokumentacioni teknik-ekonomik); neni 9, pika 4.1.5 (leje nga institucione të tjera), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Koxheri Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Koxherra” me fuqi të instaluar 0,62 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 52, datë 17.4.2015

**MBI ZBATIMIN E NDRYSHIMEVE TË
KËRKUARA NGA KOMISIONI
EVROPIAN DHE SEKRETARIATI I
KOMUNITETIT TË ENERGJISË PËR
OPINIONIN E PËRBASHKËT TË
AUTORITETEVE RREGULLATORE
SHQIPTARE, ITALIANE DHE GREKE,
TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.
135, DATË 24.12.2014, TË ERE-s**

Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015:



Në zbatim të:

- nenit 40, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;
- nenit 18, pika 2, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 17.10.2011, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar;
- direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim, direktiva 73/09);
- rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009;
- rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 korrik 2009 (në vijim, rregullorja 715/09);
- nenit 16 të vendimit të Këshillit Ministerial D/2011/02/EC, të Komunitetit të Energjisë, “*On implementation of Directive 2009/72/EC, Directive 2009/73/EC, Regulation (EC) no. 714/2009 and Regulation (EC) no. 715/2009 and amending Articles 11 and 59 of the Energy Community Treaty*”;
- vendimit të Komisionit Evropian të 16 majit 2013, lidhur me “*Exemption of Trans Adriatic Pipeline from the requirements on Third Party Access, Tariff Regulation and Ownership Unbundling laid down in articles 9, 32, 41 (6), 41 (8) and 41 (10) of Directive 2009/73/EC*”;
- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013), të datës 14 maj 2013 “*On the exemption of the “TAP” interconnector from certain requirements under Directive 2009/73/EC by the Energy Regulatory Authority of Albania (ERE)*”;
- vendimit të Komisionit Evropian të 17 marsit 2015 C (2015) 1852, “*Prolonging the exemption of the Trans Adriatic Pipeline from certain requirements on Third Party Access, Tariff Regulation and Ownership Unbundling laid down in articles 9, 32, 41(6), and (10) of Directive 2009/73/EC*”;
- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2015), të datës 17 mars 2015, “*On the prolongation of the exemption of the Trans Adriatic Pipeline interconnector from certain requirements under Directive 2009/73/EC by the Energy Regulatory Authority of Albania (ERE)*”;
- vendimit nr. 27, datë 1.3.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6),

(8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline”;

- vendimit nr. 64, datë 13.6.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 27, datë 1.3.2013, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian C(2013)2949”, nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion i përbashkët përfundimtar i rregullatorëve të energjisë mbi aplikimin e TAP AG për përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/“*Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG’s Exemption Application Autorita për l’Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)*”, në vijim *Final Joint Opinion*;

- vendimit nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi miratimin e metodologjisë së tarifave (*TAP Tariff Code*), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/*Final Joint Opinion*”, në kuadër të procedurës për përjashtimin e gazsjellësit TAP”;

- vendimit nr. 135, datë 24.12.2014, “Mbi shqyrtimin dhe miratimin e “*Energy Regulator’s Joint Opinion on TAP AG’s Request for a Prolongation of the Validity Period of the Exemption Decision/Opinion*” i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi kërkesën e TAP AG, për shtyrjen e periudhës së vlefshmërisë të vendimit të përjashtimit”;

- letrës përcjellëse nga shoqëria tregtare TAP AG, nr. prot. 329/25, datë 17.12.2014;

- kërkesës së TAP AG, për përjashtimin e gazsjellësit TAP, të datës 2 shtator 2011, e arkivuar në ERE, me nr. 478/2 prot., datë 3.10.2011;

- letrës së dërguar nga TAP në ERE, nr. 7326/27 prot., datë 11 nëntor 2014;

- letrës së dërguar nga TAP në ERE, nr. 329/24 prot., datë 18.11.2014.



Duke marrë parasysh se:

- neni 36 i direktivës 73/09, ka mundësuar përjashtimin e infrastrukturave të reja të sistemit të gazit, *Third Party Access* (më tej “TPA”);

- shoqëria TAP AG, nëpërmjet letrës së 2 shtatorit 2011, ka paraqitur kërkesën për projektin e një gazsjellësi të ri që kalon nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë dhe përfundon në Itali (më tej “Gazsjellësi TAP”), kjo kërkon që kërkesa për përjashtim të jepet së bashku nga autoritetet kombëtare rregullatore të vendeve të përfshira, thënë ndryshe: autoritetit italian (AEEGSI), atij grek (RAE) dhe atij shqiptar (ERE);

- në veçanti, instanca e parashikuar përfshinte një kërkesë për përjashtim, për një periudhë prej 25 vitesh, duke filluar nga data e hyrjes në operim të gazsjellësit, nga:

- detyrimi për *Third Party Access* (neni 32 i direktivës 73/09);

- tarifatat e rregulluara (neni 41, pikat 6, 8 dhe 10 të direktivës 73/09);

- detyrimet për ndarjen e pronësisë (neni 9 i direktivës 73/09);

- detyrimet e rregullores 715/09 (me përjashtim të nenit 19, pika 4);

- vendimi nr. 27, datë 1.3.2013, i Bordit të Komisionerëve i ERE-s, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline” (*Joint Opinion*), i ka dhënë përjashtimin formal nga nenet e përmendura më lart të direktivës 73/09 dhe rregullores 715/09;

- ERE, me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, ka adaptuar kërkesat e Komisionit Evropian dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në seksionin 4 të *Joint Opinion*;

- paragrafi 4.10.2 i *Final Joint Opinion* parashikon, në koherencë me nenin 36, pika 9, të direktivës 73/09, që vendimi i përjashtimit të humbë efektin 3 vjet pas adaptimit të tij (6 qershor 2016), në rast se ndërtimi i TAP-it nuk ka filluar ende dhe 6 vjet (6 qershor 2019) nga adaptimi i tij në rast se infrastruktura nuk është bërë ende funksionale, vetëm nëse Komisioni vendos se çdo vonesë e mëtejshme është për shkak të pengesave madhore, të cilat janë përtej kontrollit të subjektit të cilit i është akorduar ky përjashtim;

- afatet kohore të mësipërme parashikonin gjendjen e projektit në momentin e adaptimit të *Final Joint Opinion* dhe të stimujve më të mirë të mundshëm në atë moment, në funksion të datës së prezumuar të hyrjes në funksion të gazsjellësit, ku as Konsorciumi Shah Deniz dhe as TAP AG nuk kishin marrë ende vendimin final të investimit;

- në vazhdimësi, më 16 dhjetor 2014, Konsorciumi SD i ka komunikuar TAP AG, se data e dorëzimit të parë të gazit do të ndodhte në periudhën mes 1 janarit 2020 dhe 31 dhjetorit 2020;

- më pas, në letrën e 17 dhjetorit 2014, TAP AG informoi autoritetet që në bazë të njoftimit të fundit të marrë nga Konsorciumi i SD (16 dhjetor), dritarja e dytë e parashikuar nga *funneling mechanism* për shpërndarjen e gazit do të zgjasë nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2020;

- termat e propozuar do të kishin lejuar për të njëzuar datën e fillimit të operimit të gazsjellësit me kontratat themelore të transportit të gazit, sipas informacioneve dhënë nga Konsorciumi SD që nuk është e mundur që dorëzimi i parë i gazit të bëhet para janarit 2020;

- ERE, me vendimin nr. 135, datë 24.12.2014, ka miratuar kërkesën për zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së vendimit për përjashtimin, së bashku me AEEGSI dhe RAE, dokumenti “*Energy Regulators Joint Opinion on TAP AG’s request for a prolongation of the validity period of the exemption decision*” (në vazhdim “*Prolongation Joint Opinion*”), e cila i është dorëzuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë;

- *Prolongation Joint Opinion* e shtyn deri në fund të vitit 2020 kohën në të cilën gazsjellësi duhet të hyjë në operim për të lejuar përjashtimin e periudhës së vlefshmërisë, të vendimit të përjashtimit me afatin e parashikuar për fillimin e dorëzimit të gazit (deri më 2020-n) dhe në koherencë me periudhat kohore të përcaktuara, e shtyu deri më 2018-n, më datën e fundit në të cilën duhet të fillojë ndërtimi i infrastrukturës;

- më 17 mars 2015, Komisioni Evropian miratoi, duke u bazuar në nenin 36, paragrafi 9, të direktivës 73/09, vendimin lidhur me kërkesën për një zgjatje të periudhës së vlefshmërisë, të vendimit për përjashtimin e TAP AG, në të cilin ndan të njëjtën mendim me atë të autoriteteve për të zgjatur afatin e fundit, në të cilin gazsjellësi duhet të bëhet operacional deri në fund të 31 dhjetorit të vitit 2020, por nuk ka rënë dakord me nevojën për



zgjatjen e afatit të fillimit të punës për ndërtimin e infrastrukturës (i cili për këtë arsye kërkohet të jetë deri në datën 16 maj 2016, siç kërkohet që në fillim nga *Final Joint Opinion*);

- në datën 17 mars 2015, gjithashtu, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në Opinionin e tij dërguar në ERE, ka arritur në të njëjtat konkluzione me vendimin e Komisionin Evropian, të datës 17 mars 2015 (si më lart);

- siç specifikohet në vendimin e Komisionit dhe në Opinionin e Sekretariatit, vonesat nga data e vendosur fillimisht për operimin e gazsjellësit janë për shkak të pengesave të mëdha që janë jashtë kontrollit të TAP AG (vonesa kryesisht në investime përgjatë furnizimit *upstream* të projektit), por që justifikojnë datën e aplikimit; nga ana tjetër, megjithatë, vlerësohet se një zgjatje e afatit për fillimin e ndërtimit të gazsjellësit nuk është e justifikueshme, pasi që, një zgjerim i tillë do të lejojë që gazsjellësi të bëhet operacional, deri më 2020-n (për shkak të kohës së nevojshme për të arritur ndërtimin e infrastrukturës në pesë vjet, siç është deklaruar në komunikimet e fundit me TAP AG);

- Komisioni ka bërë një modifikim në nenin 11 të vendimit të tij, të datës 16 maj 2013, që zgjat deri më 31 dhjetor 2020, afati ku infrastruktura duhet të hyjë në operim dhe që lë të pandryshuar datën e skadencës, 16 maj 2016, në të cilën duhet të fillojnë punimet për ndërtimin e gazsjellësit. Të njëjtin modifikim ka bërë edhe Sekretariati në Opinionin e tij dërguar në ERE, më 14 maj 2013.

Duke marrë në konsideratë sa më sipër:

Të modifikohet *Prolongation Joint Opinion*, për ta përshtatur me vendimin e marrë nga Komisioni Evropian, në bazë të nenit 36, paragrafi 9, të direktivës 73/09 dhe, gjithashtu, për ta përshtatur me Opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë 1/2015, dërguar në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të dokumentit “*Energy Regulator’s Joint Opinion on TAP AG’s Request for a Prolongation of the Validity Period of the Exemption Decision*”/Opinionin i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi kërkesën e TAP AG, për shtyrjen e periudhës së vlefshmërisë të vendimit të përjashtimit”, në përputhje me vendimin e adaptuar nga Komisioni Evropian dhe Opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të

Energjisë, në kuadër të nenit 36, pika 9, të direktivës 73/09. Dokumenti i ndryshuar është bashkëngjitur.

2. Njoftimin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (AEEGSI) dhe Greqisë (RAE), si edhe shoqërinë TAP AG, për marrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen elektronike të ERE-s (www.ere.gov.al).

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 53, datë 17.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN E LIDHJEVE TË REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.4.2015, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga grupi i punës për disa ndryshime në “Rregulloren e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 22, datë 25.2.2012,

duke konsideruar që:

- aktet nënligjore të miratuara nga ERE nuk mund të prevalojnë mbi ligjin (konkretisht ligji nr. 8734, datë 1.2.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”) e nuk duhet të cenojnë hierarkinë e rregullave;

- duke marrë në konsideratë dhe “Rekomandimet e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”, sipas urdhrit nr. 28, datë 11.4.2014 të Komisionerit, me qëllim që aktet e ERE-s të mos cenojnë rregullimet sipas akteve të tjera ligjore në fuqi;

- duke pasur parasysh që sektori i energjisë së shpejti pritet të rregullohet me një ligj të ri, i cili do të kërkojë hartimin e akteve të reja nënligjore për t’u implementuar.



Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos miratojë ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a., për sa i përket përjashtimit nga rregullorja të klauzolave që parashikojnë marrjen e miratimit paraprak nga IQT-ja.

2. Të mos miratojë ndryshimet e propozuara nga OSHEE sh.a., për të reflektuar ndryshime të tjera në “Rregulloren e lidhjeve të reja”.

3. Të miratojë ndryshimin e propozuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pika 3.1, klauzola 6, si vijon:

“Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumenteve të regjistrimit të pronës, të tilla si: akt shitjeje, akt qiraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundshme. I gjithë informacioni i lidhjes së re, si dhe kontrata e furnizimit të klientit ruhen nga kompania OSHEE, në mënyrë elektronike dhe dokumentare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të tjera ligjore në fuqi për mbrojtjen, përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale dhe të drejtës së informimit mbi to”.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 54, datë 23.4.2015

**PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË “EURON
ENERGY GROUP” SHPK, MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 87,
DATË 26.9.2011, TE SHOQËRITË “ALB-
ENERGY” SHPK, EURON ENERGY”
SHPK DHE “ENERGAL” SHPK**

Në mbështetje të nenit 20, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 7 dhe nenit 149, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Faqe | 3356

Shqipërisë”, si dhe nenit 4, nenit 17, pika 7, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 87, datë 26.9.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për miratimin e transferimit të licencës së prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Euron Energy Group” sh.p.k., te shoqëritë “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Nga dokumentacioni i paraqitur në ERE nga shoqëritë “Euron Energy Group” sh.p.k., “ALB-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” sh.p.k. dhe “Energal” sh.p.k., sipas nenit 17 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton:

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k.

Neni 17, pika 4, germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 2, i plotësuar në mënyrë korrekte, germa “b”: Informacioni ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Vendimi me shkrim të organet drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës, i plotësuar në mënyrë korrekte;

Shoqëria “ALB-Energy” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Format i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, plotësuar në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike, i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Euron Energy” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Format i aplikimit,



sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, të plotësuara në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, plotësuar; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike, i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Energal” sh.p.k.

Neni 17, pika 2, germa “a”: Formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, i plotësuar në mënyrë korrekte; germa “b”: Dokumentet juridike administrative dhe pronësore, sipas nenit 9, pika 2, të plotësuara në mënyrë korrekte; germa “c”: Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas nenit 9, pika 3, plotësuar; germa “d”: Çdo modifikim ose ndryshim i mundshëm i dokumentacionit të të dhënave teknike i plotësuar: nuk ka asnjë modifikim apo ndryshim të dokumentacionit të të dhënave teknike.

Shoqëria “Euron Energy Group” sh.p.k. është në kushtet e ndarjes faktike në tri shoqëri të tjera, si më sipër, dhe me synimin për eliminimin e problemeve që mund të lindin si rrjedhojë e konsumimit të afateve të plota procedurale, referuar nenit 7, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Alb-Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Bele 2”, me fuqi 11 MW dhe “Topojani 1”, me fuqi 2.9 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

2. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Euron Energy” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Bele 1”, me fuqi 5 MW dhe “Topojani 2”, me fuqi 5.8 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

3. Transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Euron Energy Group”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 26.9.2011, të shoqëria “Energal” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Orgjost i Ri”, me fuqi 4.8 MW, për një periudhë 26-vjeçare.

4. Drejtorja Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Euron Energy Group” sh.p.k., “Alb-Energy” sh.p.k., “Euron Energy” dhe “Energal” sh.p.k. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

NR. 55, datë 23.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NISHOVA”, ME FUQI TOTALE 1.36 MW

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Nishova Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1,36 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Kisi-Bio-Energji” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



Neni 9, pika 1. Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.1, është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.2, është plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4.1.3, është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.4, dokumentacioni teknik-ekonomik është plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4.1.5, leje nga institucione të tjera, është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Nishova”, me fuqi totale 1,36 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 56, datë 23.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “NISHOVA ENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”, 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të

Faqe | 3358

licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Nishova Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.

Neni 9, pika 4/10, germa “a”, e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “b”, e paplotësuar.

Neni 9, pika 4/10, germa “c”, e plotësuar.

Për dokumentacionet e munguara do të njoftohet subjekti, që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Nishova Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 57, datë 23.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
 “GAEA - ENERGJIA ALTERNATIVE E
 GJELBËR” SHPK NË AKTIVITETIN E
 TREGTIMIT TË ENERGJISË
 ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., në aktivitetin e

tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 58, datë 23.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
 “GAEA - ENERGJIA ALTERNATIVE E
 GJELBËR” SHPK NË AKTIVITETIN E
 FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË
 ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 3, pika 31; 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe nenit 45, pika 4, dhe 48, pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “P”; 5, pika 1, germa “P”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE, në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- dokumentacioni i përgjithshëm, dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pikat 1, 2, 3) është i plotësuar tërësisht;

- të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, gjerat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar tërësisht;



- të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/9, germat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar tërësisht;

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GAEA - Energjia Alternative e Gjelbër” sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 59, datë 23.4.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GREEN ENERGY TRADING ALBANIA”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 60, datë 23.4.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“PËRPARIMI SK” SHPK, NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA HEC “SHTIKA”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Përparimi SK” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të



Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1.3 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.1. Të dhëna specifike për HEC është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.3. Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni teknik-ekonomik është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera është plotësuar tërësisht.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shtika” me fuqi totale 1.3 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 61, datë 23.4.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 8, 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Përparimi SK” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 4/10, germa “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar, plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “b”. Kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 9, pika 4/10, germa “c”, plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s



VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 2577, datë 29.4.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë, loti II (objektet)”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit, për pasuritë pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “objekt”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 38 047 272 (tridhjetë e tetë milionë e dyzet e shtatë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

Për sa më sipër dhe në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 336, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të botimit të njoftimeve publike, për efekt të zbatimit të ligjit nr. 8561, datë 22.12.2012, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, lutemi, konfirmimin tuaj për publikimin e kësaj kërkesë për shpronësim, sipas tekstit të mësipërm dhe listës bashkëlidhur.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR
"UNAZA LINDORE TIRANË" LOTI II (OBJEKTET)

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastr.	Numri Pasurisë	Sip. Totale	Lloji i pasurisë	Sip. Ndërtimi	Çmimi mesatar lek/m2	Vlera sipas preventivit (objekte jo banesë)	VLERE TOTALE (LEKE)	Shënime
1	Besim		Sallaku	1604	38/21/1	71	Ndërtesë 1kt	71		1243372	1243372	Konfirmim ZVRPP
2	Nazif Ylli	Asllan Asllan	Biba Biba	1604	38/22/1	110	Banesë 1kt	110	64500		7095000	Konfirmim ZVRPP
3	Selim	Sinan	Elezaj	1604	40/5/1	120	Banesë 1kt	120	64500		7740000	Çertifikatë pronësie
4	Fatmir	Shaban	Troksi	1604	40/6/1	130	Banesë 1kt	130	64500		8385000	Konfirmim ZVRPP
5	Petrit	Xhevit	Kodra	3976	236/3	256.3	Banesë 2kt	256.3	53000		13583900	Çertifikatë pronësie
			SHUMA								38047272	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 595, datë 26.3.2015, vendosi shpalljen të vdekur në datën 1.1.1961, të shtetasës Rozalia Bashi, e bija e Arianthit dhe e Kozmait, e datëlindjes 9.10.1950, lindur dhe banuese në Dhërmë, Vlorë dhe shpalljen të vdekur në datën 1.1.1956, të shtetasit Jorgji Bashi, i biri i Arianthit dhe i Kozmait, i datëlindjes 17.2.1952, lindur dhe banues në Dhërmë, Vlorë.

KËRKESË

Shtetasja Mimoza Brahilika, e bija e Aliut dhe e Ahmedies, e datëlindjes 14.10.1971, lindur në Kumbull, Mirditë dhe banuese në Paskuqan, Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Nevruz Brahilika.

KËRKUESE
Mimoza Brahilika

KËRKESË

Shtetasja Fitije Rusi, e bija e Ismailit dhe e Hikes, e datëlindjes 27.2.1951, lindur në Vlashaj,

Dibër dhe banuese në lagjen "Bregu i Lumit", Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Aqif Rusi.

KËRKUESE
Fitije Rusi

KËRKESË

Shtetasi Ragip Uligaj, i biri i Ymerit dhe i Fatimes, i datëlindjes 31.1.1931, lindur në Ura e Shtrenjt, Shkodër dhe banues në Dobraq, Shkodër, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shpalljen të zhdukur të djalit të tij, shtetasit Agim Ragip Uligaj, i datëlindjes 31.5.1966, lindur në Shkodër.

KËRKUESI
Ragip Uligaj

KËRKESË

Shtetasi Leonard Mehmeti, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Agron Mehmeti, i biri i Hakiut dhe i Hankushes, i datëlindjes 2.1.1967, lindur në Tiranë.

KËRKUESI
Leonard Mehmeti



Ndreqje gabimi

Në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 13, datë 9.4.2015, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 3.5.2010, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 54, datë 9 prill 2015, faqe 2313,

Në fjalinë e parë të pikës 5 të udhëzimit:

Ishte:

Në pikën 12.2, shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

Bëhet:

Në pikën 12.1, shkronja “d” ndryshon me këtë përmbajtje:

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë